



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 485/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vlastimir Dimic dhe Ferid Osmani, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

ARSYETIM

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik LVV e cila i drejtohet subjektit politik AAK, për shkak se me datë 12.12.2010 në shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Deçan rreth orës 10:00 është këputur kablo e energjisë elektrike, si rezultat i kësaj ky VV ka mbetur pa rrymë dhe se numërimi i votave është bërë në mënyrë të parregullt.

Ne mbështetje të pretendimeve, parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

- ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesa e LVV-së ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura si dhe ne kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 485/2010 më datën 14.12.2010.

